



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KRYETARI

Nr. 3890 Prot.

Ersekë, më 22.06.2026

Lënda: Njoftim

Të nderuar,

Bazuar në pikën 1 të nenit 14 të Ligjit Nr. 96/2025, datë 17.12.2015 për “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, pikën 1 dhe pikën 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 28.05.2026 “Për Marrëdhëniet e Punës, Strukturën dhe Kriteret e Përzgjedhjes së Punonjësve të Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit në Autoritetet Publike” si dhe Direktivën Nr. 2019/1937/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 tetor 2019, “Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit.” Numri CELEX 32019L1937, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, Nr. 305, datë 26.11.2019, me Urdhërin Nr. 303, datë 22.06.2026 të Kryetarit të Bashkisë “Për Ngritjen e Njesisë Përgjegjëse në Bashkinë Kolonjë”, ju njoftojmë se Njësia e Sinjalizimit është ngritur dhe funksionon pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm. Njësia ndodhet në Katin e Parë të godinës së Bashkisë në zyrën e Sektorit të Auditit dhe përbëhet nga:

1. Laura Skënderas, Sinjalizues me kontakt e-mail laura.skenderas@kolonja.gov.al
2. Arnold Fetallari, Sinjalizues me kontakt e-mail arnold.fetallari@kolonja.gov.al

Për sa më sipër, çdo person i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit gjatë ushtrimit të detyrës ose të lidhura me veprimtarinë e tij të punës, në zbatim të kërkesave ligjoreka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt te Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve pranë Bashkisë Kolonjë ose ILDKPKI-së sipas rastit.

Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit sipas kriterëve të parashikuara në ligj.

